



Republika e Kosovës
Republika Kosova Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Dakovica
Municipality of Gjakova
Drejtoria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenies Sociale



Nr.005 /2026

Datë:16.03.2026

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Gjakovës, duke u bazuar në Statutin e QKMF-së, neni 11.7 dhe neni 12, pika 6, me qëllim të themelimit të Këshillit të Pacientëve, më datë 16.03.2026, publikon këtë:

FTESË PUBLIKE

PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË PACIENTËVE

Me hyrjen në fuqi të Statutit të QKMF-së, përkatësisht nenit 12.6, është paraparë themelimi i Këshillit të Pacientëve. Me qëllim të zbatimit të këtij neni, Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale fton të gjithë qytetarët e interesuar të aplikojnë për të qenë pjesë e këtij këshilli.

Këshilli i Pacientëve do të përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe do të ketë mandat 5 (pesë) vjeçar.

Aplikimet mund të tërhiqen dhe duhet të dorëzohen nga data **16.03.2026** deri më **31.03.2026**, fizikisht në zyrën e Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Të gjitha aplikimet e pranuar pas këtij afati nuk do të merren parasysh nga komisioni përkatës.

Dokumentet e kërkuara:

1. Aplikacioni për të qenë anëtar i Këshillit të Pacientëve;
2. Kopja e letërnjoftimit;
3. Një letër motivuese ku shpjegohet arsyeja pse dëshironi të jeni anëtar i Këshillit të Pacientëve.

Termat e Referencës: *Në Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) është paraparë themelimi i Këshillit të Pacientëve si një mekanizëm formal i angazhimit të qytetarëve në kujdesin shëndetësor. Për këtë qëllim, DSHMS ka hapur thirrje publike për të gjithë qytetarët e Komunës së Gjakovës që janë të interesuar të jenë pjesë e këtij këshilli.*

Qëllimi: *Qëllimi i Këshillit të Pacientëve është të shërbejë si një mekanizëm formal për përfshirjen e pacientëve në proceset e vendimmarrjes, në mënyrë që të bashkëpunojnë me institucionet dhe stafin shëndetësor për të rritur cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore për pacientët dhe komunitetin.*

Objektivat:

- *Përfshirja e pacientëve në vendimmarrje lidhur me shërbimet shëndetësore;*
- *Rritja e vetëdijes së qytetarëve për shëndetin dhe të drejtat e tyre;*
- *Identifikimi i problemeve dhe nevojave të pacientëve;*
- *Forcimi i besimit dhe komunikimit ndërmjet pacientëve dhe stafit shëndetësor;*
- *Kontributi në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.*

Fushëveprimi: *Fushëveprimi i Këshillit të Pacientëve shtrihet brenda territorit të Komunës së Gjakovës dhe ka për qëllim përfaqësimin e interesave dhe shqetësimeve të pacientëve brenda kësaj komune.*

Kushtet për anëtarësim: *Anëtarësimi në Këshillin e Pacientëve është i hapur. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Gjakovës të cilët:*

- *janë mbi moshën 18 vjeç;*
- *nuk janë anëtarë të ndonjë partie politike;*
- *nuk ofrojnë shërbime shëndetësore ose farmaceutike;*
- *nuk kanë të kaluar kriminale.*

Lulzim GOQI

Drejtor i DSHMS-së

FORMA E APLIKIMIT:

EMRI: _____

MBIEMRI: _____

ADRESA: _____

DATËLINDJA: _____

SHKOLLIMI: _____

PROFESIONI _____

KONTAKTI: _____

TEL: _____

EMAIL: _____

A KENI QENË NË TË KALUARËN:

- a) PACIENT
- b) PËRCJELLËS I PACIENTIT
- c) ASNJËRA NGA KËTO

JU LUTËM NA TREGONI SE PSE DËSHIRONI TË JENI PJESE E KËSHILLIT TË PACIENTËVE:

Nënshkrimi i aplikuesit:

Data:
